



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 365/4 Prot

Tiranë, më 25.05.2021

V E N D I M

Nr.60, datë 25.05.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit administrativ, përfunduar me dhënien e masës disiplinore “vërejtje” ndaj nëpunëses së Bashkisë Berat, ***.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 365 prot., datë 1.3.2021, nëpunësja e Bashkisë Berat ***** ka parashtruar pretendimin se, procedura disiplinore e zhvilluar për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” ndaj saj, është në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi, së pari, nuk është bërë njoftimi me shkrim në lidhje me shkeljen e konstatuar dhe me fillimin e procedurës disiplinore; së dyti, akti për dhënien e masës disiplinore ka dalë nga Kryetari i Bashkisë, ndërkohë që ky akt, duhet të dilte nga eprori direkt.

Në kuadër të verifikimit të këtyre pretendimeve, u kërkua dokumentacioni përkatës në Bashkinë Berat, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi e vërtetuar sa më poshtë:

Nëpunësja *****, është nëpunës civil në pozicionin “*Specialist për Turizmin*”, në Drejtorinë e Turizmit dhe Aktiviteteve, pranë Bashkisë Berat. Me urdhrin nr. 114, datë 23.2.2021, të Kryetarit të Bashkisë, ndaj saj është marrë masa disiplinore “*Vërejtje*”, me motivacionin “*për shkelje të rregullave të etikës në komunikim me kolegët*”.

Konstatohet se, shkak për marrjen e kësaj mase disiplinore, është bërë një konflikt verbal midis disa punonjësve, ndërmjet të cilëve është përfshirë edhe punonjësja në fjalë, i cili ka ndodhur në zyrën e Drejtorisë së Turizmit dhe Aktiviteteve, gjatë kryerjes së një kontrolli rutinë për prezencën në punë të punonjësve.

Menjëherë pas ndodhjes së këtij incidenti, Sekretari i Përgjithshëm, në prani të përfaqësuesve të njesisë së burimeve njerëzore, ka thirrur në dy seanca ballafaqimi të njëpasnjëshme, punonjësit pjesëmarrës në këtë konflikt për të sqaruar situatën, dokumentuar kjo me dy procesverbale, që mbajnë datën 19.2.2021. Pas sqarimeve të dhëna dhe pretendimeve të paraqitura nga punonjësja *****, ka rezultuar se kjo punonjëse ka përdorur shprehje fyese dhe ofenduese ndaj kolegëve të saj, shprehje të cilat janë konsideruar si shkelje të rregullave të etikës institucionale, duke arritur në përfundimin e nevojës së marrjes të masave administrative.

Në këto rrethana, Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e eprorit direkt (*për shkak se pozicioni Drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Aktiviteteve ishte vakant*), ka vepruar duke nxjerrë aktin nr. 1099/2 prot., datë 23.2.2021, ku i ka propozuar titullarit të institucionit dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*”, për punonjësen *****, veprim i cili është formalizuar me Urdhrin nr. 114, datë 23.2.2021, të Kryetarit të Bashkisë.

Nga sa më sipër, duke e analizuar procesin e dhënies së kësaj mase disiplinore, në raport me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” të ndryshuar dhe në Vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, rezulton se shkelja që në fillim, është cilësuar si “*shkelje e rregullave të etikës*”, e cila klasifikohet si shkelje e lehtë, parashikuar në pikën 4/b, të nenit 57, të ligjit, për të cilën është dhënë masa disiplinore “*Vërejtje*” sipas parashikimeve në shkronjën “a”, të nenit 58, të ligjit.

Konkretisht, nga këqyrja e akteve të administruara, provohet se punonjësja në fjalë, megjithëse ka qenë pjesëmarrëse në konfliktin verbal të ndodhur në ambientet e institucionit, nëpërmjet ballafaqimit me kolegët dhe eprorët, ka marrë dijeni për faktin se kjo ngjarje është cilësuar shkelje e etikës në punë, për të cilën ka filluar ecuria disiplinore. Në këto kushte, ajo

ka mundur të paraqesë pretendimet e saj në lidhje me ngjarjen, duke iu dhënë mundësia e mbrojtjes, nëpërmjet dëgjimit të pretendimeve të saj apo mundësisë për të paraqitur e kërkuar prova në lidhje me shkeljen e pretenduar, ç'ka përbën edhe realizimin në përmbajtje të procedurës disiplinore.

Gjejmë rastin të theksojmë se, procedura disiplinore nuk është qëllim në vetvete, por në përmbajtje ka për qëllim që të sigurojë respektimin e të drejtës së nëpunësit që të marrë dijeni për fillimin e një ecurie apo procedimi disiplinor, njohjen e tij me shkeljen e pretenduar, dhënien e mundësisë për tu dëgjuar dhe shprehjen e mendimit të tij, mundësinë e mbrojtjes, duke u dëgjuar dhe paraqitur prova, hapa të cilat në këtë rast vlerësohet se janë respektuar e kryer nga ana e institucionit.

Edhe pretendimi tjetër i nëpunëses, sipas të cilit urdhri i titullarit të institucionit, është akt i dalë në kundërshtim me ligjin, vlerësohet i padrejtë, pasi Sekretari i Përgjithshëm, i cili në këtë rast paraqitet si eprori i drejtpërdrejt i punonjësës në fjalë, pasi ka kryer hetimin administrativ dhe shqyrtimin e fakteve që kanë dalë nga ballafaqimi, ka arritur në konkluzionin për të dhënë masën disiplinore “Vërejtje” për nëpunësen *****, e njëkohësisht me aktin nr. 1099/2 prot., datë 23.2.2021, ka njoftuar Kryetarin e Bashkisë Berat, duke kërkuar konfirmimin e tij. Ky i fundit, me Urdhrin nr. 114, datë 23.2.2021, ka konfirmuar përfundimisht dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” për nëpunësen në fjalë, veprime këto që janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.

Nga gjithë sa u parashtua më sipër, nisur nga përmbajtja e dokumentacionit në të cilat materializohet procedura disiplinore, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në konkluzionin se, pavarësisht mangësisë së njoftimit me shkrim, kjo procedurë disiplinore, në përmbajtje, është kryer në respektim të të drejtave të nëpunësit civil, duke i siguruar nëpunëses ***** të drejtën e mbrojtjes, dëgjimit të pretendimeve të saj, mundësisë së paraqitjes apo kërkit të provave, etj., e cila ka përfunduar me nxjerrjen e vendimit përkatës nga drejtuesi i institucionit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, të kryer për verifikimin e ligjshmërisë së procesit administrativ të zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses *****, i cili ka përfunduar me dhënien e masës disiplinore “*vërejtje*”, pasi veprimet e kryera gjënden në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Berat, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha